



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Adresa: Fushë-Arrëz, Prefektura Shkoder, Tel: 027123131, email: bashkiafushearrez@hotmail.com

Nr. 958 Prot.

Fushë-Arrëz, më 4 prill 2022

Lënda : Kërkesë për publikim të planit vjetor të rekrutimit të pranimi në shërbimin civil

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

TIRANË

Në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 18, si dhe të VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për Planin Vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur dërgojmë për publikim planin vjetor të pranimi në shërbimin civil të bashkisë Fushë-Arrëz, për vitin 2022.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore

Sokol GJONI

KRYETARI

Fran TUCI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
Sektori i Burimeve Njerëzore

Adresa: Fushë-Arrëz, Prefektura Shkoder, Tel: 027123131, email: bashkiafushearrez@hotmail.com

Nr. 959 Prot.

Fushë-Arrëz, më 04 / 04 / 2022

VENDIM

Nr. 04 Datë 04 / 04 / 2022

PËR

PËR

PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2022, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; VKM nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”; Vendimin nr.49, datë 23.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë Fushë-Arrëz, njësive administrative dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara, për vitin 2022”; urdhërin nr. 459, datë 13.12.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë Fushë-Arrëz, njësive administrative dhe institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, për vitin 2022”, si dhe informacionin e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, të ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese, kryetari i bashkisë:

V E N D O S I

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në shërbimin civil, në administratën e bashkisë Fushë-Arrëz dhe të njësive administrative përbërëse, për vitin 2022, pjesë e shërbimit civil, do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) gjithsej, sipas kategorive të mëposhtme:

- a. Për kategorinë ekzekutive: 13 (trembëdhjetë):

- 1) Specialist i Burimeve Njerëzore
- 2) Specialist tatim-taksash
- 3) Specialist i kontrollit Ushqimor dhe Cilësisë
- 4) Specialist i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike
- 5) Specialist i Çështjeve Sociale
- 6) Koordinator për dhunën në familje

- 7) Specialist arkive dhe protokolli
- 8) Specialist i zyrës së integritet europian dhe diasporës
- 9) Specialistë finance dhe i ndihmës ekonomike në njësinë administrative Qafë-Mali
- 10) Specialist finance dhe tatim-taksash në njësinë administrative Blerim
- 11) Specialist i ndihmës ekonomike në njësinë administrative Blerim
- 12) Specialist finance në njësinë administrative Fierzë
- 13) Specialist i ndihmës ekonomike në njësinë administrative Fierzë

b. Për kategorinë e ulët drejtuese: 2 (dy):

- 1) Përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm
- 2) Përgjegjës i sektorit të tatim taksave

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

-Fran TUCI-

